

UDC 316.483 : 316.334.3 (497.115)

Prof.dr. Avni Avdiu

KOSOVA NË MES KOLEKTIVIZMIT DHE INDIVIDUALIZMIT
КОСОВО ПОМЕЃУ КОЛЕКТИВИЗМОТ И ИНДИВИДУАЛИЗМОТ
KOSOVO BETWEEN THE COLECTIVISME AND INDIVIDUALISME

Abstract

Kosova has undergone through manifold changes, the impact of which will be long enough for its future. In its entirety, these changes are covered by numerous radical transformation, not only of political and economic nature, but above all, of socio-cultural and those based on value. One of the issues that was less discussed, if not at all, and which is the worthiest to be debated, unequivocally is the striking transition from collectivism of yore to today's individualism. This transition has resulted in significant changes in every pore of life, changes which have risen the curiosity and wonder of the majority of people, but which so far have remained unexplored and unstudied.

As it is known, the crucial and substantial problem before the war in Kosova was the systematic violence of the Serbian regime; which was a generator of all crisis. The extreme period of manifestation of this violence ended with extremely heinous acts of institutional terror.

Living during this time for the Albanian meant to wake up and to sleep with the prominent slogan of Shakespearian monologue, "Hamlet": "To be or not to be - that is the question." So, he was persecuted and tortured mercilessly even when he tried to survive, by providing his own morsel.

Keywords: individualism, collectivism, privatization, traditional norms, transformations based on value, mutual assistance, solidarity, altruism, philanthropy.

Kolektivizmi: si opsion, alternatië apo si imponim rrethanash?!

Shtrengesa e lakut të zullumit shtetëror serb përskaj të këqijave të panumërta pati vetëm një anë pozitive: ndikoi dukshëm në homogenizimin e popullatës. Me qëllim që të mbaheshin fort radhët, në përpjekje të sfidimit të okupatorit, secili e merrte njëri-tjetrin si shumë të afërt. Dhimbja, pikëllimi dhe vuajtja e ndokujt, ishte njëherësh edhe reflektim te të tjerët. Ata merrnin pjesë jo vetëm në ndarjen e fatkeqësisë, në keqardhje e ngushëllim, por edhe me veprime konkrete kontribuonin në zbutjen e halleve dhe dertëve të atij që ishte i prekur dhe që kishte nevojë. Gjithkund ishte prezente bamirësia dhe humaniteti në vepër. Solidariteti ndërvëllazëror e mbante gjallë flakadanin e mbijetesës. Andaj edhe pse të trajtuar si qytetarë të rendit të dytë, pa kurrfarë të drejte, shqiptarët ia arritën që të

rezistojnë stoikisht kundruall dhunës dhe reprezaljeve. Familjet, fqinjët dhe farefisi kishin rrënjë të forta solidariteti, kështu që i dobëti, i sëmuri, më i moshuari, fëmija, skamnori dhe ai që ishte viktimë e përndjekjeve të okupatorit, që të gjithë ishin të rrethuar nga kujdesi i të tjerëve, të cilët zotëronin ndjenjat e dashurisë, mirëkuptimit dhe ndihmës së ndërsjellë. Pa ngurrim ndahej koha e mjaftueshme dhe mundësitë materiale, vetëm e vetëm për t'ju garantuar një siguri, shërbim dhe mbështetje psikologjike për ata të cilët kishin aq shumë nevojë.

Në njëfarë mënyre ky solidaritet ishte kompatibil me normat tradicionale që përgjatë shekujve kanë qenë të mpiksura thellë në superegon e çdo shqiptari dhe që erdhën në shprehje në formën më të mirëseardhur mu në momentet më se të nevojshme.

“Për shekuj me radhë, shqiptari ka jetuar në mënyrë kolektive. Individu u bindej pa ngurruar urdhrave të familjes; familja jetonte nën hijen e fisit nga i cili ajo përfaqësonte vetëm një qelizë; fisi duhej t'u nënshtrohej normave të fshatit, ndërsa të gjithë duhej ta njihnin dhe respektonin para së gjithash frymën udhëheqëse të kombit”(Fuga, 1998:131).

Prof.dr. Anton Kolë Berishaj - ligjërues i sociologjisë në fakultetin filozofik në Prishtinë u shpreh: “Popujt e tjerë nuk kanë mundur t'i kuptojnë disa forma të organizimit para lufte, se si funksiononte 3%, solidarizimi me familjet e varfra dhe mbledhja e ndihmave humanitare. Shihet se kemi të bëjmë me një popullatë, e cila ka sens për këso lloj organizimesh, për arsye se ka pasur nevojë ta zhvillojë atë sens. Në rrethanat e paraluftës - vazhdoi ai - para së gjithash ka qenë i rrezikuar kolektiviteti dhe është shumë logjike që format e homogjenizimit të ndodhin ashtu siç kanë ndodhur. Në pajtimin e gjaqeve për shembull të tubimi në Verrat e Llukës ku u mblodhën 500 mijë njerëz, kemi një shfaqje që është si refleksion i homogjenizimit, përmes formave të buta që nuk janë konfrontim i drejtpërdrejtë me okupatorin, por një lloj parapërgatitje për konfrontim”.

Përkitazi me këtë kleriku dr. Don Lush Gjergji shërbyes në kishën e Binçës - njëherësh edhe kryetar i SHH “Nënë Tereza” u shpreh: “Kemi jetuar njëri afër tjetrit, njëri me tjetrin dhe shpeshherë kemi jetuar edhe njëri për tjetrin, sepse ndjenja e kërcënimit dhe e rrezikimit ka bërë që të përforcohet kjo ndjenjë njerëzore dhe kombëtare, duke i dhënë rezistencës sonë një fuqi edhe më të madhe. Thjesht ne kemi hetuar - shton ai - se nuk ishte në pyetje rrezikimi i disave, por i të tërëve, pra çdo pësim e kemi konsideruar pësim tonin”.

Edhe akademik Pajazit Nushi ligjërues i psikologjisë në fakultetin filozofik në Prishtinë dhe njëherësh kryetar i Këshillit për Mbrojtjen e Lirive dhe të Drejtave të Njeriut, u shpreh se “në rastet e rrezikshme niveli i solidaritetit përgjithësisht është në nivel të lartë edhe atë jo vetëm të shqiptarët”.

Me fjalë të tjera që të tre, në prononcimin e tyre që na dhanë lidhur me këtë temë, ishin të mendimit se përpara luftës ka dominuar kolektivizmi si vlerë tradicionale e rëndësishme për t'u përballuar me problemet e imponuara.

Rokada vlerore

Po tash..., shtrohet pyetja si qëndrojnë punët? Ekziston apo jo akoma ai kohezion, i cili për vite të tëra ishte shëmbëlltyrë vlerash kundruall egërsisë së regjimit diktatorial serb? Fatkeqësisht përgjigjja është jo. “Natyra disi kolektiviste e jetës morale të dikurshme nuk mund të mbijetojë më”(Fuga, 2000:270). Ajo po shembet si kullë prej letre para syve tanë.

Rendi i ri vleror që është në ndërtim e sipër, është duke krijuar një mentalitet të ndarë, të pavarur dhe pothuajse të pakomunikueshëm me mentalitetin e mbërthyer në rendin e 'vjetër tradicional'. "As fqinjësia, dikur aq me peshë në marrëdhëniet solidare midis shqiptarëve, sot nuk mund të krenohet se mbetet me ato vlera që ka qenë dikur.." (Fuga, 2003:57). "Lidhja familjare është vënë disi kokëposhtë" (Fuga, 2000:369, 370-371). Brenda familjes gjenden breza me përvojë jetësore dhe me bindjen morale krejt të ndryshme.

Se një individualizëm i tillë është duke gjetur hapësirë për kultivim në Kosovë, tregon qartë një studim i bërë aty rreth viteve 98' - 2000'. "Të influencuar nga idetë perëndimore, rinia në jug-lindje të Evropës e gjithashtu edhe në Kosovë - sipas këtij studimi - janë duke u bërë gjithnjë e më të individualizuar në sjelljet e tyre".¹

Faktikisht, i tërë procesi aktual zhvillohet në saje të një komunikimi mjaft të ndërlikuar ndërmjet të kaluarës së zbehur, të tashmes së paqartë dhe të ardhmes së paparashikueshme. Derisa pjesa konservative-tradicionale e shoqërisë sonë, përfaqësojnë një mendësi të shabllonizuar rigide, të formësuar dhe të rrënjosur historikisht nga tradita, pjesa tjetër, të moderuarit-respektivisht të rinjtë, formësohen gjithnjë e më shumë nën ndikimet mediale të mediave të ndryshme, si botërore ashtu edhe vendore.

"Jeta shoqërore ndodhet në mes të rrugës midis një tradite morale të ruajtur pak a shumë mirë dhe vlerave të reja që po zënë terren në mënyrë graduale, të lindura si përgjigje ndaj një stili tjetër jetese dhe si pasoja të logjikshme të hapjes së gjithanshme të vendit. Duhet pranuar se familjet e sotme qytetare ose fshatare nuk janë homogjene nga pikëpamja e formimit moral të anëtarëve të tyre" (Fuga, 2000:269). Në këto rrethana "hapësira shoqërore bëhet e fragmentarizuar dhe shumë e individualizuar" (Fuga, 2000:28). "Secili në fakt shikon vetëm 'hallin' e vet" (Fuga, 2000:217).

Është vështirë të thuhet se individualizmi a është përbrendësuar në formë kulture nga jashtë o mos është rrjedhojë e ndryshimit të brendshëm të marrëdhënieve të sapokrijuara në rrafshin shoqëror. Ndoshta mund të jetë edhe njëra edhe tjetra.

"Shumë nga të rinjtë që shkuan jashtë shtetit si refugjatë janë kthyer me vlera të reja për të cilat shoqëria kosovare nuk ishte e përgatitur"². Qarkullimi i ndihmave ekonomike nga bashkëfamiljarët në mërgim, pashmangshmërisht shoqërohej edhe me qarkullim të vlerave të reja, lehtësisht të përvetësueshme nga të gjithë. Kështu në skenë doli "...një lloj individi që del jashtë çdo moralshmërie dhe që mendon se sot kanë vlerë vetëm pasuria, paraja, rehatia, përmbushja me çdo kusht e çdo lloj dëshire" (Fuga, 1998:130). Në këtë mënyrë "logjika individualiste zëvendëson mendësinë kolektivistike të kohës...Individi e vë veten në qendër të një gjithësie imagjinare që e ndërton, duke i lënë të tjerët në periferi të universit të tij shoqëror e intelektual" (Fuga, 1998:130).

"Shoqëria (shqiptare) bëhet gjithmonë e më tepër individualiste....Gjithkush tani dëshiron të pasurohet me të gjitha mjetet dhe mundësitë" (Fuga, 2000:273).

"Shpirti i popullit është shprishur pas ndryshimeve rrënjësore që është bërë zakon t'i paraqesin sot si modernitet. Shpërfillja e vlerave shpirtërore dhe morale përkon me zhvillimin e vlerave materiale. Qëllimi dhe mjetet i kanë ndërruar vendet. Paraja që ishte mjet bëhet edhe qëllim, ndërsa jeta mjet. Shoqëria e sëmurë shpirtërisht e ka humbur kuptimin e solidaritetit. Interesi vetjak del mbi interesin e përgjithshëm. Çdo qytetarë mbetet i kufizuar tek e përvitshmja" (Delson, 2000:158).

¹ Kovatcheva, 2000; Machacek, 1998. Cituar sipas: Rrjeti Rinor Kosovar, "Hulumtimi për të rinjë", f. 5

² IRC/UNDP, 2001b. Cituar sipas: Rrjeti Rinor Kosovar, "Hulumtimi për të rinjë", f. 5

Tashmë normat tradicionale nuk janë bërë vetëm se démodé, por edhe qesharake. Nuk janë të rralla rastet e relativizimit normativ, por gjithnjë e më evidente janë edhe rastet e nihilizmit etik...s'ka më vlera të dallueshme...gjithkush është sajues i tyre më vete.

Duke u shërbyer me fjalët e Hannah Arendit mund të themi, se me shuarjen e traditës “nuk mbeti gjë tjetër veçse një gjendje konfuzioni dhe mungesë rrugëdaljeje” (Arent, 1998, 23).

Individualizmi si humbje e empatisë

Rrënjët e reja vlerore po lëshohen në truallin e një gjendjeje të rëndë socialo-ekonomike. S'mbahet mend të ketë pasur hendek kaq të madh e të thellë diferencimi midis shtresave shoqërore: që dikush të mos ketë fare, kurse dikush tjetër të ketë së tepërmi. Ky hendek “në rritje midis të pasurve dhe të varfërve dhe faktorë të tjerë ndikojnë që niveli i zhgënjimit të popullsisë nga politika dhe nga institucionet politike të jetë i konsiderueshëm” (Fuga, 2000:278).

Sot përballë tablosë së mjerueshme përplot hallexhinjsh qëndron një grumbull i sevfallinjve. Në një anë kasolle, tenda, shtëpiza gjysmë të rrënuara, një mori lypësish, të papunësh dhe skllevër të kohës së re, kurse nga ana tjetër dyqane të shumta me lloj-lloj mallrash, sallone të mëdha mobiliesh luksoze, makina më moderne, kafene, kafiteri dhe restorante të stërmbushura, por edhe aso që ngarendin në ndërtimin e shtëpive- ndërtesa, hotele e motele që ngjasojnë në pallate.

Në revistën “*Kosovarja*” numër 11, 2005, në faqen 3 një lexues me të drejtë shtronte këtë paradoks. Të gjithë e dinë se Kosova është në skamje dhe se 60 % e popullatës përballen me varfëri, por kur të shikosh përditë ngrihen shtëpi e ndërtesa luksoze, kafiteritë janë të mbushura me të rinj, rrugës mahnitesh me vetura luksoze...pyes vallë ku po marrin para gjithë këta?...

Askush nuk senzibilizohet e lëre më të alarmohet nga situata katastrofale në të cilën jetojnë familje të shumta skamnorësh. Lajmet rrëqethëse për jetën dramatike të varfanjakëve kryesisht të dalë nga ish-vatrat e luftës, shumëkush i ndjek pa kurrfarë interesimi. “I ngiti t'untit s'ia di” - thotë një urti e jonë popullore. I indinjuar nga kjo indiferencë totale Don Lush Gjergji shprehet: ”Kur shqipëtarë vie deri te kjo që të thotë për fqin e vet e bile edhe për vëllanë e tij “s’e kam asgjë”, çka e kam përjetuar pas luftës, për mua ishte shumë tragjike. U kam thënë atyre - shton ai - vallë amerikani, gjermani e italian i ka më të afërt se sa e ke ti?” Sipas tij kjo “është një dukuri sikur rrëshqet njeriu majtas e pastaj kthehet e rrëshqet djathtas. Tash është një fenomen kur shkohet në skaj ose në teh të individualitetit, ku njerëzit e theksojnë vetveten, ku tjetri shpeshherë është rival, rrezik, shikohet në prizmin e kundërshtarit”. Pajazit Nushi është i mendimit se kjo pasojë e këtillë e zhvillimit të marrëdhënieve ndërnjerëzore, kushtëzohet nga ndërrimi sistemor. Sipas tij “kalimi prej një sistemi në sistemin tjetër është gjithmonë i vështirë dhe është i vështirë në të gjitha mjediset, e posaçërisht në mjediset që kanë një nivel të ulët të zhvillimit ekonomik dhe social. Shqiptarët e Kosovës i takojnë këtij niveli”, - mendon ai.

Duke i pasur parasysh këto aspekte, lind pyetja se a mund të pohojmë me të vërtetë se botëkuptimet individualiste sundojnë tani pa kurrfarë limiti?

Qysh në kohën e tij Emil Dyrkemi duke e shikuar shoqërinë e re me njëfarë pesimizmi paralajmëronte edhe rrezikun e shtimit të individualizmit. Kjo sipas tij mund të paraqes

kërcënim për solidaritetin shoqëror; sepse nxit interesa egoiste dhe krijon tendencë për anomni.

Sot kur Kosova është shndërruar në një bastion antagonizmesh ballkanike në të cilën pleksen antipode të shumta shoqërore, gjasat që të shtohen parashikimet e Dyrkemit janë gjithnjë e më të mëdha.

Individualizmi po u dikton njerëzve që përparësi t'i jepet vetëm mirëqenies personale. Individualistët e rinj që po dalin gjithnjë e më tepër në shoqërinë kosovare në kërkim të mundësive të tjera më të mira për veten, shköputen nga të tjerët për të formuar sensin personal të vetes. Ata ushqejnë edukimin për të qenë të pavarur dhe për të menduar vetëm për veten. Heqjen dorë nga vlerat tradicionale, si: bujaria, mikpritja, ndihma reciproke, solidariteti, altruizmi, filantropia etj., ata e kuptojnë si mundësi integrimi me botën e qytetëruar, si vlerë dhe kulturë progresiste dhe si mekanizëm për të ndërtuar profilin e ri të personalitetit konform kushteve dhe rrethanave të reja të sapokrijuara.

Kështu lidhjet fisnore e fqinjësore tashmë janë zbehur ose kanë filluar të shturen. Ftohja midis miqve të dikurshëm, kalon në një indiferencë të plotë dhe argumenti është i lehtë për t'u gjetur dhe për t'u arsyetuar gjithçka: kohët janë bërë aq intensive saqë është vështirë edhe të takohesh me të tjerët. Nuk dëgjohen veç se ato biseda që kanë të bëjnë me biznesin, karrierën, famën dhe afirmimin e unit. Thjesht në qarkullim janë vetëm ato fjalë që kanë lidhje me sigurimin e interesit të ngushtë personal. Të tjerat trajtohen si llafe të kota e monotone, idiotësi ose humbje kohe, pavarësisht se mund të kenë të bëjnë me artin, kulturën dhe me diturinë.

Mendësia e re - në krijim e sipër - e shoqërisë kosovare është duke u shoqëruar gjithnjë e më tepër me një kompleks të çuditshëm inferioriteti në raport me të tjerët, sa i përket vlerave, traditës dhe kulturës. Kjo rrezikon seriozisht përpjekjet për faktorizim dhe për ruajtjen e subjektivitetit kombëtar dhe kulturor karshi globalizimit.

Parulla kryesore e këtij metanarracioni, "drejt integritit dhe globalizimit" (Ferraj, 2003:32), është shndërruar në moto udhërrëfyese në të gjitha fushat e aktivitetit shoqëror: politik, ekonomik, kulturor etj.

Jemi një popull që është në kërkim e sipër të një identiteti të ri, kërkim ky që pashmangshmërisht duhet të kontekstualizohet në rrjedhat e reja të globalizimit kulturor.

Në kontekst të kësaj Anton K.Berishaj mendon se individualizma të tilla në kushte tona mund të jenë të tepruara. "Mua më duket që ne ende nuk kemi hyrë në fazën e zhvillimit, ku mund të durohen stërtheksimet e individualizmave", - theksoi ai.

Shqetësimi vetëm për të plotësuar nevojat materiale kalon në ankth permanent deri sa më në fund shndërrohet në mani dhe lakmi të pakufishme. Kjo "etje dhe uri e pashuar dhe e pangopshme" ka dobësuar dukshëm pasurinë intelektuale të shoqërisë, duke i zbehur energjitë dhe potencialet e saj. Tashmë edhe mjekët e kanë harruar betimin e Hipokratit. Dëshira e tyre dhe e kolegëve të tyre farmacist është që të ketë sa më shumë të sëmurë. Pra njerëzit që rrjedhimisht duhet të ishin më humanist janë shndërruar në dashakeqës. Edhe udhëheqësit shpirtëror, ata që predikojnë fenë, në vend se ta fokusojnë interesimin për përhapjen e bindjeve religjioze dhe përsosjen shpirtërore të popullatës, më tepër interesohen se kush po vdes, ngase marrin para për ceremoni varrimi. Ndërkaq, autorë të ndryshëm intencë paraprake në shkrimet e tyre ose në krijimtaritë artistike, kanë kalkulimet utilitariste materiale, duke abstrahuar mesazhet e zakonshme etiko-estetike, por edhe edukative. E të mos cekim fare avokatët, juristët, ekonomistët, inxhinierët etj. Me një fjalë, interesi i ngushtë personal i lidhur fort nga kushtëzimet sistemore dhe

ekonomiko - shoqërore ka bërë që njerëzit të tjetërsohen nga njëri-tjetri. Ndryshe thënë trendët e jetës së tanishme shfaqen me humbjen e besimit reciprok të njerëzve.

Individualizmi si kompleks inferioriteti

Në kushtet e këtushme të një tranzicioni pasluftë, të ndërrimit radikal të raporteve ndërshoqërore, ku privatizimi dhe ekonomia e tregut zhvillohen në mënyrë difuze dhe konfuze, gjasat që të thellohet gjendja kaotike janë gjithnjë e më të mëdha. Me rritjen e prosperitetit parcial vetëm sa rriten edhe dëshirat, madje dëshirat të gjithë. Kërkesat janë më të mëdha se mundësitë, gjë që pashmangshëm ngushtia shpirtërore thellohet. Bile siç thotë një fjalë e urtë latine pikërisht ata që kanë sa më shumë, aq më tepër po dëshirojnë. Dëshira dhe simboli i bollëkut dhe i pasurisë së munguar ka ngritur tensionin e garimit dhe konkurrencës. Të gjithë dëshirojnë të tregojnë se kanë. Lidhur me këtë Don Lush Gjergji tha: "Kjo është një dukuri se ne jemi shoqëri, e cila ka ndjenja të rivaliteteve të ndryshme dhe të afirmimit të vetvetes. Dikur jemi koritur dhe fikur rreth fejesave dhe martesave, sepse dasma e madhe tregonte se jemi familje e madhe dhe kemi prestigj. Ishte koha e tokës; vriteshim ndërmjet veti për megje. Tash i kemi harruar tokat. Tani prestigji është në automjete, veshmbathje në ndërtimin e shtëpive, që në të shumtën e rasteve është një investim shterp. Sot shqiptari jeton më tepër në atë se çka mendojnë e çka flasin dhe si e vlerësojnë të tjerët, e jo vetvetja. Ky është mentaliteti që në mënyrë horizontale ndikon dhe kontrollon njëri - tjetrin". Ai na solli një shembull nga jeta e tij; konkretisht nga kontaktet me mërgimtarët në diasporë. "Në Zvicërr u takova me një njeri që më bëri be se nuk kishte më tepër se 20 franga në xhep. Kur arrita pranë banesës së tij e vërejta një mercedes të parkuar aty në oborr. Iu drejtova: i kujt është? Më tha: "I imi". Po si është e mundur që t'i kesh 20 fr në xhep dhe një mercedes kaq të bukur e pyeta i habitur; të duket se përputhen e nuk janë kontrast? Ai ma ktheu: 'Mos ta kisha edhe këtë çka do të thoshin të tjerët'. Pra, ishte përgjigje tipike shqiptare. Domethënë jetojmë për të tjerët dhe s'kemi fuqi të jemi vetëvetja. Jemi nën ndikimin e opinionit, çka thonë të tjerët", - theksoi Gjergji.

Si pasojë e një shpërthimi të nevojës për konsum, shpeshherë mallrat kanë natyrë kontradiktore. Rrugët e qyteteve janë mbushur me automjete dhe janë bërë thuajse të pakalueshme për qytetarët, plot zhurmë, me ndotje dhe erë të rëndë karburanti, me një trafik kaotik dhe që prodhon stres e nervozizëm.

Etja e ethshme dhe oreksi i pafrenueshëm

Në vend të paganizmit primitiv, tash ka lindur idhujtaria moderne. Tanimë nuk adhurohen si më parë putat, yjet, totemët dhe kafshët, por të hollat, luksi dhe sendi i konsumit. Njeriu është privuar nga çdo rëndësi, nga të gjitha qëllimet përveç vetëmbajtjes. Racionaliteti në lidhje me sendet e konsumit që trumbetohet me pompozitet, shkon në dëm të tij, minimizon rolin dhe rëndësinë e tij në shoqëri dhe shkon "deri tek iracionaliteti në lidhje me ekzistencën njerëzore" (Horheimer, 1989:86).

"Nga kjo pikëpamje kuptohet edhe qëndrimi tepër kontradiktor i qytetarit shqiptar, i cili nga njëra anë është i pakënaqur nga problemet shoqërore të akumuluar, por nga ana

tjetër i gëzohet bollëkut të tregut. Të gjithë ankohen për gjithçka dhe të gjithë krenohen, mburren, ndjehen të kënaqur, në mënyrë intime ose publikisht, për ato që kanë mundur të blejnë: veturën e re, televizorin e ri, shtëpinë, celularin. Gjendja është tejet e çuditshme. I njëjti njeri, aty për aty mund të kritikojë, madje dhe të shajë gjithçka, po aty, në atë çast dhe vend, mund të flasë me tone pozitive për jetën e tij materiale. Të gjithë mund të ndjehen të kënaqur në mënyrë euforike dhe po të gjithë mund të ndjehen fatkeq. Është pikërisht ajo gjendje e *'euforisë fatkeqe'* për të cilën ka shkruar Herber Markuze. Markuze shkruan se dëshira për të plotësuar nevojat materiale është më e fortë sesa kërkesa për drejtësi sociale dhe barazi më të spikatur në planin ekonomik. Dëshira e papërballueshmë për mallra konsumi nuk stepet në këtë rast as përpara faktit që shumë nevoja mbeten *'nevoja të kota të krijuara artificialisht'*. Dëshira dhe simboli i bollëkut dhe i pasurisë së munguar është ende e pashterur. Të gjithë dëshirojnë të tregojnë se kanë. Pasuria nuk është më një çështje personale për t'u konsumuar në mënyrë intime, të paekspozuar dhe modeste. Përkundrazi, pasuria dhe mirëqenia duhet treguar publikisht. Ato bëjnë pjesë në ndërtimin e personalitetit të individit në shoqëri. Shpesh herë një mall konsumi ose një shërbim tepër i kuptueshëm nuk ka asnjë funksion tjetër real veçse dukjen para të tjerëve, tregon shenjë e pjesëmarrjes në një grup të privilegjuar shoqëror, simbolikisht shërben vetëm për t'i dhënë publikisht mesazhet e duhura. Dëshira për të plotësuar nevojat materiale me mallra konsumi bëhet kriteri themelor i jetës së individit. Jetojmë kohën e diktatit të konsumit, *'të diktaturës së tregut'*, të dëshirës për ta prekur sendin e konsumit me po atë përkëdheli dhe me po aq epsh sa edhe pjesët trupore të afta për të ngjallur një energji të fortë libidinale, do të thoshte Frojdi. Është ky diktat që rregullon sjelljet shoqërore të individit dhe politikës. Përpara dëshirës dhe obsesionit për konsum, individi i harron pabarazitë e tjera shoqërore, problemet shoqërore që grumbullohen gjithnjë e më shumë, paqartësinë e perspektivave të zhvillimit ekonomik të vendit, rënien e nivelit kulturor dhe arsimor të shoqërisë, çekuilibrimet në jetën politike, situatën gjeopolitike të rajonit. Është një lloj *'euforie fatkeqe'*, sepse ajo pengon të shihet me objektivitet rruga nëpër të cilën ecën shoqëria, nuk lejon parashikimin e ngjarjeve dhe situatave të papëlqyera që mund të trokasin në derë. Rëndësi ka që të konsumosh pa pasur tjetër kokëçarje, bile pa pyetur nëse ajo që konsumon plotëson një nevojë materiale ose vetëm *'urinë'* e një iluzioni, shpeshherë të dëmshëm. Pa pyetur nëse ajo që konsumon është fituar me një veprimtari që përputhet me normat më fillestare të moralit ose është në kundërshtim me to, pa pyetur për thirrjet e zbehta të ndërgjegjes që humbasin e tretën në detin e grumbullimit të pasurisë me çdo mjet" (Fuga, 2003: 121-124). Thjesht siç thoshte Andre Gorz individi shndërrohet në konsumator pasiv që gjen kënaqësi në konsumin e prodhimeve.

Lektisja kaq marramendëse pas sendeve, demonstroi dobësinë e spikatur njerëzore hysterinë, dalldisjen dhe skizofreninë e emocioneve. Truri përballë një numri të madh variacionesh merr një pozicion të përcudnuar. Individi është i pozuar keq dhe problemi konsiston te një konstrukt i caktuar mental që s'ka as forcë e as fuqi të dalë nga lëvizhja e vetëmahnitjes dhe vetëmagjepsjes. Po t'i referohemi terminologjisë së *'fenomenologjisë së Hegelit'* do të thoshim se kjo *'vetëdije e re fatkeqe'* në vend se ta suprimojë objektin, shkakton incidentin e paprecedent duke lejuar që objekti ta suprimojë subjektin.

Lidhur me këtë Lush Gjergji dallon dy dukuri që ia vlen të analizohen mirëfilli. "Dukuria e parë sipas tij është materializmi, kur njeriu e sheh suksesin vetëm në prizmin e fitimit dhe të përfitimit, pra atëherë kur malli, pasuria, paraja sundon njeriun. Pasuria është

shërbëtor i mirë, por edhe zotëri ose sundimtar i keq. Në atë moment kur pasuria më shërben mua që unë të kem diçka dhe që unë përmes saj të kem kënaqësinë të bëjë për të tjerët, është shërbëtores e mirë. Në të kundërtën, atëherë kur pasuria më udhëheq mua, nuk kam asgjë, sepse krijon një koprraci të tmerrshme. Natë e ditë punon dhe fiton, por ai fitim nuk të kënaq as ty as familjen dhe as shoqërinë. Njerëzit që mendojnë se paratë mund të bëjnë gjithçka janë vetë gati të bëjnë gjithçka për para. Prandaj materializmi i tepruar rrënon dhe shpartallon vlerat njerëzore, etike, fetare dhe kombëtare. Kur njeriu i përzien mjetin dhe qëllimin i humb edhe mjetin edhe qëllimin. Dukuria e dytë e pranishme te ne - sipas Don Lushit - është hedonizmi i tepruar”.

Luksi kundruall mjerimit: pashpirtësi dhe striptiz antihuman

Kur kemi parasysh gjendjen në të cilën ndodhemi, imponohet pyetja se vallë sa do të jetë i arsyeshëm një hedonizëm i shfrenuar këtu te ne. Zh.Dalamber thoshte se luksi është krim kundër njerëzimit, përderisa ka qoftë edhe një njeri që gjendet në nevojë. Në këtë kontekst dijetari i madh islam imam Shafiu thoshte: “Kur të shihni një të varfër, dine se pasaniku e ka vjedhur hisen e tij”. Realiteti dëshmon se ata që patën fatin të kenë me bollëk, nuk e kanë ndërmend të gjejnë veten në interaksion me të tjerët, me ata që kanë nevojë e të paktën me ata që sakrifikuan për këtë liri në saje të së cilës ata janë aty ku janë. Pra, ata kanë hequr dorë të kërkojnë kënaqësi në raportet ndërvëllazërore. Në vend të kësaj, ata “...e gjejnë veten në mallrat që kanë blerë, e gjejnë shpirtin tek autovetura e tyre, tek aparaturat elektronike, radiofonike, te shtëpitë e veta dykatëshe, te pajisjet shtëpiake, me të cilat kanë mbushur shtëpitë e veta” (Markuze, 2006:34). Me fjalë tjera “irracionaliteti po ua jep formën fakteve njerëzore” (Horheimer, 1989:136).

Kosova është mbushur me të papunë. Edhe një numër i konsiderueshëm i ish-punëtorëve me mbylljen e shumë fabrikave ose pakësimit të punës, janë larguar nga puna.

Shumica prej tyre janë shndërruar në raste të rënda sociale. Një pjesë shëtit rrugëve, ndërsa pjesa tjetër del në një vend të caktuar ku shpresohet të gjendet ndonjë punë ditore a javore. Thënë troç, këta nevojtarë dalin në tregun e vetes së tyre për t’ua shitur fuqinë punuese atyre që ndërtojnë diçka ose kanë diç për ngarkim - shkarkim. Numri i tyre shtohet dita - ditës, saqë trotuaret ku presin çastin e shpresës, në të shumtën e rasteve janë aq të dendura sa e pengojnë edhe qarkullimin e kalimtarëve. Çdo ditë për ta është vetëm një sfidë sizifi.

Skena që krijohet prej tyre është një uvertyrë për shumë poet e prozatorë të tipit migjenian. “Shtresa të ndryshme të popullsisë ndodhen në pragun e leckosjes ose janë tashmë të përfshirë nga ky proces mjerimi. Sa shumë Lula të vocërr sheh nëpër rrugë....Varfëria ka zaptuar vendin...”(Fuga, 2003:23)

Ka edhe familje që jetojnë ende në tenda, ku në vend të dritareve u qëndrojnë foliet plastike dhe ku në vend të dyerve u qëndrojnë dërrasa gjysmë të kalbura. Në dhomat e improvizuara prej najloni s’ka as kushte minimale jete. Në brendi të tyre shtrojat e përbaltura nga reshjet janë tejet të papërshtatshme për t’u ulur mbi to e lëre më të vësh kokën për të fjetur. Shpeshherë brenda tyre jetojnë edhe persona të hendikepuar dhe fëmijë të sëmurë pa fije shprese në sy. Rrallëherë kur ndodh që ndonjë bamirës rasti t’i gëzojë me lodra e sheqerka, ata mbeten me gisht në gojë, duke hedhur vështrime habitëse. Të folurit e tyre holofrastik është roman i gjallë. As me këtë rast s’mund të mbledhin forcë për ta kthyer sadopak gëzimin. S’mund të paramendohet se sa zor është

për prindërit e tyre t'i shohin fëmijët e vet në këtë gjendje. Tendat e ngritura përballë rrënojave në oborre edhe disa vite pas përfundimit të luftës, janë apoteozë e një apokalipsi moral që rëndon mbi supet e shtetit të brishtë dhe e mbi shpirtin e pasanikëve të prishtë.

Mbi një decenie minatorët kanë qenë shtresa më e ndërgegjësuar e popullatës. Rezistenca e tyre me grevë urie në zgafellet e nëntokës gjatë kohë ka qenë sinonim i qëndresës më të sofistikuar. Ata qëndruan të palëkundur përballë stuhive që pretendonin t'i shembnin themelet kushtetutare të shtetësisë së Kosovës. Ndërkaq sot edhe minatorët janë pjesë përbërëse e armatës së madhe të të papunëve. Shumica e tyre nuk kanë kurrfarë mbështetje sociale, andaj s'është për t'u çuditur që sot rrugëve takojmë edhe minatorë lypës.

Ka raste jo të rralla kur fëmijët e braktisin edhe shkollën fillore për të nxjerrë kafshatën e bukës për vete e për familje. Ata kryesisht shesin cigare ose kartela mbushëse ose diç tjetër. Kështu dita - ditës shtohet numri i lypsarëve. Ata klithin për ndihmë e mëshirë. Disa janë të verbër, të tjerët janë të gjymtuar, ka të shtyrë në moshë dhe nëna që dalin me foshnje në krah. Në vendet ku ka qarkullim më të madh kalimtarësh ata gjenden në çdo dhjetë metrash. Ndodhë që mes tyre të ketë edhe zënka sporadike për shkak të zënies së pozitive të volitshme nga njëri-tjetri.

Megjithatë, shumica e kalimtarëve kalon pranë tyre me indiferencë. Ka të tillë që mendojnë madje se shtimi i numrit të lypësve ka të bëjë me forcimin e rrjetit mafioz që qëndron prapa tyre. Sidoqoftë injorimi, distancimi dhe madje edhe anatemi mund të jetë shembull i paprecedent i humbjes së ndjesisë njerëzore. Britmat e tyre që përzihen e shkrihen me zhurmën e makinave dhe me jehun e goditjeve të çekanëve sidoqoftë do të duhej të dëgjoheshin.

A ka provuar ndonjë i pasur të hyjë në lëkurat e tyre? Eh... sikur ta dinin ata ç'është mjerimi, vetëm sikur ata të kuptonin këtë, mjerim nuk do të kishte! A nuk i kanë parë vallë apo nuk kanë dashur t'i shohin ata se sa vetë ditën e natën fusin krahët thellë nëpër kontejnerët e bërllokut për të gjetur gjë për ta shuar urinë? Nuk duken këto skena rrëqethëse në shekullin 21 në mes të Evropës?! Po, por jo për të gjithë, sepse këtu si duket ndërgegjja ka fjetur. Në vend të saj zgjuar e vigjilent qëndron policia. Ajo u tregua e shkathët në kapjen në flagrancë të një skamnori, të cilin e arrestoi në Skenderaj duke vjedhur kapakë kontejnerësh të bërllokut. I pidentifikuari i pyetur për veprën e tij "*kriminale*" u përgjigj se s'kishte kurrfarë burimi jete dhe se kapakët i grumbullonte me qëllim që t'ua shiste atyre që i mbledhin hekurishtet e vjetra. Ja pra, edhe kështu sigurohet kafshata e bukës në Kosovë. Rrugëve kalimtarët mund të bien duke ecur në ndonjë pusëtë, të cilës i mungon kapaku. Shumë kalimtarë kanë qenë viktime të pakujdesisë së tyre, sepse gati të gjithë kapakët e pusëtave të kanalizimit mungojnë. Për dikë kjo mund të duket qesharake, por siç thoshte dramaturgu i njohur modern Eugen Lonesko në një artikull të botuar më 1961 në gazetën "Combat", "ne jemi mësuar të qeshim për çka do të duhej të qanim". Nga romani i Viktor Hygos "Të mjerët" mësojmë se si protagonistin Zhan Valzhani i uritur dhe i raskapitur, për të mbajtur shpirtin gjallë vjedh një copë buke. Në vështrim të parë duket sikur ai është fajtor, sepse ligji e dënon vjedhjen. Mirëpo në të vërtetë ai nuk është fajtor, sepse fajtor kryesor është vetë sistemi shoqëror që s'u krijon kushte të varfërve për fitimin e një kothere buke. Është po ashtu vetë ai sistem shoqëror i padrejtë që u krijon hapësira të pasurve për shumëfishimin e

pasurisë së tyre. Fajtori i pafaj në këtë rast pati plotësisht të drejtë se veproi ashtu siç veproi.

I pambështetur nga askush, i lënë i pamëshirë nën **mpresat** e fatit dhe i braktisur padrejtësisht nga e drejta shoqërore, skamnori tjetërsohet nga vetvetja, mohohet fizikisht dhe nënçmohet shpirtërisht, nuk ndihet mirë, por si i mjerë, i shkretë, i shterur dhe pa kurrfarë mundësie që t'i vetërealizojë potencialet e tij. Ai në vete mban një ortek të madh emocional, që sa më tepër që rrokulliset aq më kërcënues bëhet për rrethin e tij. Kur ai e ndien se jetën e çon së koti ose nuk e kupton se përse jeton në botë, ai bëhet personazh tragjik. Ëndrrat më të mira e më të pastra të njerëzve të thjeshtë pësojnë fiasko në përplasje me realitetin e shëmtuar.

De Gaulle Charles (1890-1970) theksonte se “nuk është e pranueshme dhe nuk është e mundur që nga kaq shumë vdekje, sakrifica e shkatërrim dhe kaq heroizëm, të mos kemi një humanizëm më të madh e më të mirë” (Karagjozi, 2002:49). E “gjëja më e keqe që mund t'i ndodhë një populli, është kur ai nuk është në gjendje të analizojë të kaluarën e vet. Një popull pa kujtesë është i prirë për të vuajtur nga neuroza dhe për të përjetuar vazhdimisht një përvojë të dhimbshme” (Fuga, 1998:22).

Shtrohet pyetje ku është ajo farë ‘ndershmërie intelektuale’ siç e quante përfaqësuesi i racionalizmit kritik Karl Poper ajkën e inteligjencies së kombit?! Pse nuk shkruhet të paktën për këto gjëra? Kot pres shkrime...kot shfletoj gazeta...kot shpresoj që sa më shpejtë të paktën këto gjëra të dalin në dritë...të hidhen në letër...të sensibilizohet opinioni për kobin e madh që po sjell kjo noshalancë dhe kjo indiferencë kaq cinike. S’ka gjë veç se aty-këtu që preket shkarazi ndonjë rast...pastaj pllakos qetësi e madhe...s’ka komente...jeta vazhdon...Gjithçka është në gjumë...heshtje mortore...natë e zezë...errësirë e pambarim...Veç ëndrra mund të ketë...fjetja e të gjithëve ofron veçse gërhitjen e tmerrshme që alarmon për një të ardhme nebulente, pa shtegdalje të qartë.

Çdo ditë në faqet e gazetave mund të lexohen, çdo ditë në radio e TV mund të dëgjohen dhe në faqe interneti mund të shihen lajme të ndryshme që njoftojnë për raste të shumta e alarmante që herë - herë marrin edhe epilog tragjik. Të kequshqyer, të zhveshur dhe në stinë dimri edhe të mërdhirë, shumë fëmijë përfundojnë në spitale. Prindërit e tyre të tronditur nga pamundësia që të ndërmarrin diçka pllakosen nga depresionet psikike, trauma dhe në raste ekstreme edhe varen.

Theksimi i procesit të individualizimit ekstrem si përshkues thelbësor i zhvillimeve kulturore, sociale, ekonomike etj. pashmangshmërisht rezulton jo vetëm me dezintegrimin kolektiv por edhe me disperzimin e vetë individëve. Ky vetëdisperzim individual manifestohet përmes trajtave nga më të ndryshmet si p.sh.: shtimi i numrit të vetëvrasjeve, sidomos pas luftës, është fakt mjaft domethënës në këtë drejtim. Të dhëna ende jo të zyrtarizuara alarmojnë mjaft situatën sociale dhe psikologjike të individit kosovar. Ndonëse në këtë fenomen padyshim se janë të implikuar faktorë të shumtë, sidomos ai ekonomik, përfshirja e ndryshimeve të vrullshme kulturore në sistemin aktual vleror, mendohet të jetë i pakontestueshëm.

Dyrkemi konsideroi se akti i vetëvrasjes vie si rezultat i shuarjes dhe mospasjes së solidaritetit...” (Fuga, 2003: 29).

Për Kantin, vetëvrasja paraqet “ikje prej përgjegjesisë së shoqërisë”. Ndërsa në shoqëritë postmoraliste, vetëvrasja nuk paraqet asgjë më tepër se sa një “dramë psikologjike dhe tragjedi intime” (Kullashi, 2003:220).

Prandaj, në shoqëritë me organizim të tipit individualist, të mbështetur ekskluzivisht në interesin ekonomik, tipike këto për botën perëndimore, vjen deri tek atomizimi i tyre dhe shpërbërja në “individ të mbyllur brenda vetmisë së zemrës së tyre” (Tocquevill).

“Individi rritet i mbyllur në ‘burgun’ e lirisë së tij... Po të përdorim shprehjen e filozofit ekzistencialist francez Satrit, për këtë qenie individualiste dhe egoiste ferri personifikohet prej njerëzve të tjerë... frika ka zbritur në tokë dhe djalli është bërë tjetri” (Fuga, 2000:377).

Privatizimi - nxitës i individualizimit

Situata aktuale ekonomike, “pavarësisht nga treguesit sasiorë të saj, ka bllokuar punën, prodhon papunësi gjithnjë e më të madhe, ka nxjerr në ‘breg’ fuqinë e punës” (Fuga, 2000:254).

Pakënaqësia ka pllakosur të gjithë: shitësit, zanatçinjtë, furrxhinjtë, taksistët etj. Ata ankohen se nuk ka punë ose nuk ka fitim. Shkakun e vetëm e shohin te mungesa e parasë. Para s’ka sepse s’ka punë, kurse vende pune s’ka sepse s’ka investime. Është krizë dhe përditë do të jetë edhe më vështirë - shprehen ata, duke qenë unanimit se vetëm kapitali i jashtëm dhe investimet mund të jenë shpëtim nga kriza që po ashpësohet çdo ditë e më tepër.

Vendet e pakta të punës që hapen ndonjëherë, kriteret e pranimit i kanë të paracaktuara në mënyrë të fshehtë. Lidhjet, mitoja dhe korrupsioni vijnë në plan të parë. Në kolonat e gjata pranë sporteve për dorëzimin e dokumentacioneve të duhura dëgjohen si në refren zërat: “pa pasur dikë tëndin, nuk mund të punësohesh”. Ato pak vende të punës të hapura në sektorin privat janë të rezervuara ekskluzivisht për gjininë femërore edhe atë me kushte të çuditshme si për shembull: ‘të jenë sharmante, të bukura dhe simpatike’. Kështu që, nuk dihet se vallë është konkurs për vende pune a për zgjedhje misi e fotomodele. Njerëzit në këtë mënyrë tjetërsohen ndërmjet veti, sepse çdonjëri bën përpjekje latente ta shfrytëzojë tjetrin si vegël.

Don Lushi mendon se “dhuna më e madhe është kur njeriu degradohet deri në atë shkallë sa bëhet send e mall në duart e dikujt. Ai thekson se jemi në rrezik që ta keqtrajtojmë dhe ta keqpërdorim njëri-tjetrin”. Si meshkujt ashtu edhe femrat e prostitutojnë personalitetin e tyre që të krijojnë dobi personale. Në vend që të shprehin individualitetin e tyre të vërtetë, njerëzit e veshin maskën e përzemërsisë, kujdesit dhe interesimit në mënyrë që të manipulojnë me të tjerët dhe kështu ta fitojnë bukën e përditshme. “Aspektet e personalitetit shiten dhe blihen si çdo mall tjetër”, - theksonte Rajt Millsi.

Shkalla e madhe e papunësisë e ka vënë femrën në një pozitë të vështirë sa s’ka më. Behxhet Shala - drejtor i Këshillit për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut thotë se: “rastet e abuzimeve seksuale nga ana e shefave të ndryshëm të ndërmarrjeve janë në numër të madh. Këtë e ka konfirmuar edhe zëdhënësi i SHPK-së Refki Morina, i cili theksoi se ka pasur raste të abuzimeve seksuale nga pronarë lokalesh afariste. Biznismenët moronë me këto gjeste të pahijshme sikur duan që nga krijesa fizikisht e dobët, të gjejnë shumë potenciale dhe resurse shfrytëzimi.

“Sa i varfër është njeriu që s’ka gjë tjetër veç parave” - tërheq vërejtjen Graf, kurse Balzaku pohonte se paraja është plaçkë e ndyrë vetëm atëherë kur zhduken ndjenjat humane. Se sa inteligjentë janë këta biznesmenë mjafton t’i kundrosh pagëzimet dhe reklamimet e ndërmarrjeve të tyre. Të shumta janë shitoret që shesin pajime nusërie e që

e mbajnë emrin etika. Kjo ngase pronarët e kanë ngatërruar konceptin etikë me estetikë. Në hyrje të Ferizajt ekziston një kompleks shitoresh të perdeve me emërtime interesante: ‘Kometa’, ‘Nasa’, ‘Galaktika’ etj., kështu që një i huaj do të habitej mos vallë ka hyrë në ndonjë zonë të observatoriumit kozmik. Në reklamime të shumta në mes tjerash thuhet edhe kjo: “kemi mallra me kualitete cilësore”, çka shihet se ata fjalën kualitet as që e kuptojnë. Pagëzimi i ndërmarrjeve në bazë të emrit ose mbiemrit të pronarëve nënkupton reklamimin e vetvetes. Dhe të çohen mornicat tek i dëgjon se si me gojën plotë thonë kur t’u konvenojnë diçka: ‘epo kështu e ka kapitalizmi... ne jemi Evropë!’. Ndërkaq kur diçka nuk u shkon për shtati interesave të tyre në tregti, nuk ngurrojnë të thonë: ‘shiko mos e krahaso vendin tonë me Gjermaninë, Francën... dallimet janë të mëdha’. Në këtë mënyrë “...njerëzit e korruptuar kërkojnë të legjitimojnë ideologjikisht degradimin e tyre moral” (Fuga, 1998:160).

Përndryshe konkurrenca në ekonominë e tregut më shumë ka krijuar urrejtje sesa ndonjë mirëqenie, besnikërinë e ka zëvendësuar me tradhti, kurse miqtë i ka bërë armiq.

Ekonomia e tregut në vend të cilësisë më tepër po ofron gjëra të rreme dhe artificiale, “Marrëdhëniet ndërindividuale janë bërë tepër komplekse dhe kontradiktore”(Fuga, 2001:421).

“Nëpërmjet privatizimit, prona e dikurshme kombëtare po i nënshtrohet një procesi të shpejtë shpesh tepër kaotik, pa rregulla dhe të ashpër ndarjeje dhe rindarjeje....prona private e konceptuar si një procedurë përvetësimi e pasurive të dikurshme kombëtare, në fakt ka nxitur një proces përjashtimi moral dhe ontologjik të njërit nga fushat e perceptimit dhe të veprimit të tjetrit. Tjetri është një lloj rivali i rrezikshëm, një konkurrent në luftën për të...” (Fuga, 1998:156). Agjencia Kosovare e Mirëbesimit e cila është kompetente për ndarjen e tenderëve shpeshherë është akuzuar për kriteret e saj.

“Pas gjithë atyre privatizimeve, edhe ligjet e fizikës kanë mbetur pa u privatizuar”(Fuga, 2003:29).

“Në këtë betejë të ashpër akumulimi fillestar i kapitalit, luhet pa rregulla loje. Ai që kontrollon sa më shumë trafike ilegale mallrash dhe njerëzish, ka shansin të bëhet gjithnjë e më i pasur se të tjerët”(Fuga, 1998:156).

Si problem më vete është edhe çështja e pronave kontestuese, në veçanti e atyre serbe. “Konfliktet lidhur me pronësinë janë të pranishme gjithandej dhe shpesh kanë një natyrë agresive dhe të dhunshme”(Fuga, 2000:242). “Për troje dhe banesa të serbëve ka pasur dhjetëra e qindra zënka, një pjesë e të cilave ka përfunduar në vëllavrasje, madje edhe në mes të afërmeve.

Në këso rrethanash ”duhet pranuar që edhe puna, që parimisht është një përpjekje për të ardhmen e unit tonë dhe për atë të pasardhësve tanë, bëhet diçka e kotë; njeriu mendon vetëm si të grumbullojë pasuri përmes parasë së fituar lehtë, ai nuk ka më qejf të prodhojë, por thjesht ta qarkullojë paranë që ka hyrë në vend...”(Fuga, 1998:143).

“Dukuritë e tilla sipas Don Lushit janë tipike dukuri primitivizmi, të garimit për të krijuar një lloj prestigji të ri. Kjo dëshmon dhe tregon për mungesën e personalitetit, vetëdijes, orientimit dhe mungesës së përcaktimit që unë të jem vetvetja. Ata thonë “kam jetën time, punën, familjen dhe botëkuptimin tim”. Shqiptari kur e sheh se tjetri ka çelur pompën e benzinës, mundohet medoemos ta çel edhe ai, mundësisht t’ia pengojë tjetrit punën dhe suksesin vetëm e vetëm të dëshmojë para të gjithëve se vetëm ai është i aftë. “Mund të vërehet se individualizmi kthehet në moskokëçarje ndaj tjetrit, madje në eliminim të tjetrit”(Fuga, 1998:143).

Kështu që në kushte amullie statusore dhe në ambiguitetin sistemor, privatizimi kuptohet vetëm si rast i volitshëm për interesat segmentare dhe afrodisiak për egocentrizëm.

Moralizimi i privatizimit dhe i ekonomisë së tregut përmes së drejtës ligjore

Dyrkemi, edhe pse kishte konsideratë ndaj theksimit të lirisë individuale, ai megjithatë atë e shihte si kërcënim për njësimin shoqëror.

Filozofi amerikan Xhon Rolls mendonte se nuk mund të këtë barazi politike nëse shoqëria nuk kujdeset për të ekuilibruar disi pabarazitë shoqërore. Shqetësimi për të ruajtur barazinë e shanseve është nga më kryesoret në demokraci. Dikush fillon të ketë mundësi për të ndërmarrë iniciativa personale më të mëdha jo se është më i zoti se të tjerët, por sepse paraardhësit e tij i kanë lënë trashëgim të mira materiale që nuk i kanë të tjerët. Liria e iniciativës personale të gjithkujt nuk është më një e drejtë personale e çdo qytetari që hyn në jetën shoqërore, por përbën një sistem strukturor të vendosur qysh më parë dhe që i imponohet gjithë shoqërisë duke privilegjuar disa dhe duke ndëshkuar të tjerët. Sa më tepër kalon koha, shprehet Xhon Rolls, aq më shumë sistemi del nga shinat e ekuilibrit demokratik dhe shkon drejt një modeli që parashikon privilegje të padrejta. Paraardhësit e këtyre njerëzve do të jenë më të privilegjuar se të gjithë njerëzit e tjerë të brezit të tyre. Barazia e shanseve në jetë kështu merr fund, sepse dihet që ata që janë më të pasur dhe që kanë trashëguar më shumë se të tjerët, kanë mundësi më të mëdha jetese dhe veprimtarie se bashkëkohësit e tyre më të varfër. Një njeri shumë i zoti, por i varfër, ka mundësi të ecë shumë më pak në jetë se sa një njeri fare i paaftë, por që ka trashëguar pasuri. Pasuria më e madhe jep mundësi shkollimi më të mëdha, jep diploma më të larta, jep karriera publike më të mira, jep lidhje të vendosura më lart në hierarkinë shtetërore, pra jep të drejta reale politike shumë më të mëdha. Pabarazia shoqërore jep si pasojë të pashmangshme një padrejtësi politike në rritje, pra e kthen shtetin në një mekanizëm në dobi të një grupi të caktuar njerëzish. Rolls mendon se pabarazitë shoqërore dhe ekonomike bëhen të padrejta, domethënë kthehen në padrejtësi shoqërore, atëherë kur ato nuk vijnë aspak nga meritat personale të individëve, as nga puna dhe veprimtaria e tyre shoqërore. Atëherë ato pengojnë individët e tjerë të kenë shansin për të provuar veten e tyre në 'luftën për jetën'. Të tilla padrejtësi shoqërore sjell, sipas Rollsit, konkurrenca e lirë në një shoqëri tregu. Pasuria prodhon gjithmonë e më shumë pasuri, duke i bërë të varfrit gjithmonë më të varfër. Konkurrenca, duke shkaktuar grumbullimin gjithnjë e më të madh të pasurive në disa duar, krijon kështu kushtet që dëmtojnë barazinë e qenieve njerëzore. Njerëzit nuk janë kështu as të barabartë, as me mundësi të barabarta jete dhe pune, as nuk gëzojnë shanse të barabarta jete dhe pune, as me shoqërinë dhe as me shtetin. Konkurrenca e shfrenuar dhe e pakontrolluar krijon, sipas Rollsit, një botë privilegjesh. Më të varfrit kanë më pak mundësi të ndjekin shkollat, kanë më pak mundësi për studime afatgjata që japin diploma të larta, kanë më pak asistencë intelektuale dhe mbështetje morale për të bërë karrierë, kanë më shumë rreziqe për të rënë në botën e krimit, kanë më pak lidhje të fuqishme me sferat e larta që mbështesin karrierat profesionale etj. (Fuga, 2003: 139-148)".

Pabarazia shoqërore sjell si pasojë të pashmangshme një padrejtësi politike në rritje, pra politikën e kthen në instrument dobiprurës për një grup të caktuar njerëzish. Pastaj, padrejtësitë shoqërore bëhen ai terren që e tjetërsojnë edhe natyrën e drejtësisë juridike. Normat dhe ligjet e shtetit, duke mbrojtur padrejtësinë shoqërore, humbin natyrën e tyre

fillestare dhe bëhen të padrejta. Nuk janë të rralla rastet kur vjedhësit e gjërave të imta dënohen më tepër se vjedhësit profesionist ose ata të krimit të organizuar, më shumë dënohen incidentet e trafikut rrugor, sesa grupi i zënë i narkomafisë etj. Pra, me mito, korrupsion dhe reketizëm vihet pushteti kleptokratik, i cili nuk posedon asnjë grimë fuqie për ndërmarrjen e ndryshimeve të nevojshme. Në kushtet e një hendeku të thellë klasor midis grupeve shoqërore që e përbëjnë shoqërinë, pra midis më të pasurëve dhe më të varfërve, në kushtet kur shtresat e varfëra dhe të pafavorizuara ekonomikisht nuk pajtohen më me sistemin shoqëror në fuqi, është e pamundur që shteti i së drejtës, që institucionet demokratike, që paqja shoqërore të mbahet në këmbë. Mu për këtë është i domosdoshëm telosi etik edhe në raportet e sapokrijuara ekonomiko - shoqërore.

“Polarizimet ekstreme sociale - theksoi Pajazit Nushi, nuk mund të jenë produktive në zhvillimin e mirëfilltë të Kosovës. Sado të jenë negative - shtoi ai - varet prej masave që merren në ndërkohë”. Barazia sociale kundërshtohet nga pabarazitë ekonomike të pafundme. Shtrohet pyetja se mos vallë po e jetojmë kohën për të cilën Blater thoshte se interesat personale do ta udhëheqin botën.

Lidhur me këtë Pajazit Nushi tha: “Ky shpërpjesëtim që ekziston në mes grupacioneve të ndryshme sociale, është pasojë e shumë faktorëve, ndër të cilët më i rëndësishëm është konceptimi i politikës së drejtë sociale. Mungesa e një koncepti të shëndoshë të mbrojtjes sociale të individëve, ka bërë që disa me guximin, aftësitë, kontributin, inteligjencën dhe trimërinë e tyre të mbërrijnë nivele të larta të pasurimit jo të ndershëm. Kësisoj po diferencohet një grupacion i vogël i individëve, i cili grupacion ka të mira materiale të pakufizuara, kundruall grupacionit më të gjerë të popullsisë, e cila vuan prej mungesës së këtyre të mirave. Sot kemi raste ekstreme të pashpjegueshme. Personalisht kam kaluar nëpër tri sisteme social - politike. Nëpër sistemin e përfundimit të Luftës së Dytë Botërore, nëpër sistemin e socializmit centralist deri më vitin 74, pastaj pas vitit 74 të vetëqeverisjes socialiste. Mirëpo ndonëse kemi qenë të varfër nuk kemi shënuar ndonjë rast që foshnja e ndonjë familjeje të vdes prej të ftohtit. Jam i sigurt - vazhdoi ai se prej numrit të madh të maturanëve që përfundojnë maturën ditëve të ardhshme, nuk do të kenë mundësi të regjistrohen në studime universitare për shkak të pozitës financiare që kanë familjet e tyre. Shumë nxënës bile edhe të klasave fillore dalin me karrocë për të fituar ca euro e për t’i çuar në familje për t’u siguruar bukë. Ndërkaq edhe disa studentë që sakrifikojnë e kursejnë, por që e duan me zemër shkollimin vijnë e dëgjojnë ligjëratat, por me lukth të zbrazur, sepse s’kanë ç’të hanë”. Këtë që ma pohoi akademiku i nderuar në intervistë, kam pasur rastin ta shoh me sytë e mi gjatë studimeve, duke marrë një shok i imi gjalpë nga kontejneri i bërllokut për të ngrënë bukë me të.

Shteti social nuk duhet të lejojë një funksion të pakontrolluar të pronës private. Në të kundërtën do të kishim shpërndarje të pabarabartë të pasurisë kundruall ish-sistemit që ishte shpërndarës i barabartë i varfërisë. Pra dosido do të na shfaqeshin ekstremet që do të tundnin herë do kurdo themelet e stabilitetit. Në realitet mekanizmat përgjegjës përpos disa deklaratave performative nuk kanë bërë diç relevante në përmirësimin e gjendjes. Janë trivializuar jo vetëm shkaqet por edhe pasojat. Lidhur me këtë Pajazit Nushi tha se: “po që se këto rrjedha ecin me këtë ritëm, me këtë formë të angazhimit të organeve të pushtetit që i kemi, mendoj se nuk do të mund të bëhej fjalë për një zhvillim të shoqërisë civile dhe për afirmimin e vlerave të kësaj shoqërie për dhjetë - pesëmbëdhjetë vitet e ardhshme. Prandaj vendi i shqyrtimit të çështjeve zhvillimore të Kosovës në këto organe që i kemi duhet të ndryshojë, duke futur hierarkinë në shqyrtim

të çështjeve. Kam punuar 15 vite në organet e dikurshme qeveritare dhe kam përvojë, andaj shoh se shqyrtimi i burimeve ekonomike për ekzistencë të familjeve nuk pret shtyrje të kohës. Duhet Banka Ndërkombëtare që i ka nxjerr vetë përqindjet e familjeve me varfëri ekstreme t'u jap perspektivë këtyre familjeve. Duhet ta nxitë parlamenti ynë, qeveria jonë. Organet tona duhet të gjejnë zgjidhje për t'ju siguruar ekzistencë popullsisë. Kemi mjaft vende të varfra në rruzullin tokësor. Angazhimet e institucioneve të ndryshme vendore dhe ndërkombëtare nuk i kanë çuar këto vende në këtë pozicion ekonomik, në të cilën ndodhen familjet shqiptare të Kosovës, sepse organet e atyre vendeve dhe ato ndërkombëtare marrin masa për eliminimin e shkaqeve të këtyre pasojave. Rendi i shqyrtimit me qëllim të gjetjes së burimeve për ta përmirësuar këtë gjendje, ky rend kam përshtypjen se është i mangët. Besoj se Kosova ka njerëz të guximshëm dhe intelektualë të lartë që mund të fusin rend më të arsyeshëm për shqyrtimin e këtyre çështjeve që të gjejnë mekanizma të veçantë me të cilët mekanizma u sigurohet socializim i drejtë i fëmijëve tanë. Jam i sigurt se kur duan të gjejnë njerëzit zgjidhje, ata i gjejnë ato. Kur ka dëshira për të bërë diçka gjenden mënyrat, kur ato mungojnë gjenden arsyet. Jam i sigurt se edhe në këtë situatë ka zgjidhje. Pajazit Nushi mendimin e tij e përmbyll me bindjen se sikur të jetë angazhimi serioz i përbashkët i fuqive politike, administrative dhe ekonomike, trendet dhe drejtimi i rrjedhave zhvillimore të Kosovës, mund të ndryshojnë në favor të mirëqenies së pjesës dërmuese të popullsisë. Kjo njëherësh mbetet shpresa dhe dëshira e çdonjërit që frymon në këto hapësira”. Nisur nga këndvështrimi i përgjithshëm gjatë shtjellimit të kësaj tematike neuralgjike njëmend mund të vërehet një ekskursion prej tablosë “është” në atë “duhet të jetë”, por ç’do kur ndërmjet ekzistueses dhe projektit ideor, njeriu edhe më tej mbetet genia më tragjike. Sidoqoftë, synimi konsiston në sendërtimin e së brendshmes, mjerisht nën trysinë e së jashtmes.

Snobizmi e bën individualizmin edhe më vulgar

Duke i pasur parasysh të gjitha këto, vend për komoditet, luks e eufori dalldisëse nuk ka. Për këtë edhe Dyrkemi sugjeron që interesat egoiste të cilat, dominojnë në botën afariste dhe tregtare duhet të zëvendësohen me kodeksin etik, i cili do t'i theksonte nevojat e shoqërisë në tërësi. Edhe Habermansi tërheq vërejtjen që prona private në funksionimin e saj duhet të përputhet me interesat e shoqërisë në tërësi. Pa solidaritet shoqëror nuk mund të jetojë për një kohë të gjatë asnjë shoqëri. Pa solidaritet nuk mund të funksionojë pra as edhe ekonomia e tregut dhe as prona private. Mu për këtë shoqëria shqiptare ka nevojë për më shumë solidaritet se çdoherë.

Është indikative si duket se përveç faktorëve të përgjithshëm që kushtëzojnë lindjen e individualizmit siç janë: urbanizimi, lulëzimi i pasurimit, lëvizshmërisë së madhe demografike, ekspozimit në masmedia, konkurrencës në ekonominë e tregut dhe përzjerjes së shtresave me identitet kulturor të ndryshëm, te ne është edhe një faktor tjetër - përvetësimi i gjithçka që vjen nga perëndimi.

“Kur flasim për Perëndimin, nuk kemi për qëllim vetëm Evropën ose vetëm SHBA-të, e as vetëm Kanadanë ose vetëm Australinë. Perëndimorja, mënyrë e rrënjosur në traditën hebraiko-të krishterë - thotë Habermas - gjithsesi ka tipare dalluese karakteristike... perëndimi, si konturë shpirtërore, përfshinë më shumë se Evropën vetë”.

Sot jetojmë në një proces pothuajse të pafrenueshëm “amerikanizimi”. Është pikërisht ky dominim, ai i cili globalizimin e ngjyros me nuanca imperialiste, duke i dhënë formën përfundimtare një imperializmi kulturor (Golstein, 2003:440).

“Imitimi i Amerikës nga të huajt është bërë sot një dukuri mbarëbotërore. Kjo nuk është vetëm çështje e modave kulturore, stileve shoqërore ose modeleve të konsumit. Ajo gjenë shprehje edhe në politikë si në nivelet më serioze, ashtu edhe në ato të dorës së fundit”(Brzhezinski, 2001:101).

Pra gjendemi përballë një imperializmi kulturor gjigand dhe të pasfidueshëm (Stagner, 2005:93).

Don Lushi pohon se “... për ne liria shpeshherë është anarki. Ndiqet rruga të bëjë si më duket ose të bëjë si bëjnë të tjerët. Në këtë rrafsh përvetësimi i disa shablloneve perëndimore merret si diçka e pakontestueshme që doemos duhet imituar. Mirëpo - siç theksoi Don Lushi - e keqja që emitohet është dyfish e keqe”.

Sipas Anton K Berishajt “ne deshtëm a s’deshtëm u desht që të orientohemi dhe t’i pranojmë e t’i përqafojmë ato vlera që na u afruan nga ndërkombëtarët. Shpeshherë ajo që ata na ofronin ishte një dozë tepër e fortë. Neve na duhet kohë, kemi nevojë për kohë që ta marrim veten. Vlerat ndërkombëtare - thotë ai - nuk them se nuk janë të mirëfillta, por nuk janë të adaptuara për rrethanat dhe shijen tonë. Berishaj mendon se atëherë kur kalon euforia njerëziteti i kthehen vetvetes. Euforia dhe entuziazmi duket se kanë kaluar dhe nevoja e tepërt e njëjtësimit me turmën dhe kolektivitetin dhe nevoja e futjes në kolektivitet e në turmë që të shkrihesh në të është një material harxhues. Edhe solidariteti në përgjithësi është një material harxhues, harxhohet kur kalojnë rrethanat që në njëfarë forme e nxisin dhe atëherë e krijojnë. Konsideroj - tha ai - se jemi në një etapë të zhvillimit që nuk jep rast dhe as mundësi që ne të jemi aq të gatshëm që të solidarizohemi”.

Megjithatë nëse vazhdon që gjërat të kuptohen kështu në të ardhmen pritet që shumë dukuri të shndërrohen në dush të ftohtë për shumëkënd. Lidhur me këtë dr. Anton K Berishaj shtoi: “Duhet të shkojmë kah krijimi i një modeli të kapshëm që na sjell stabilitet e jo një model se gjithçka që vjen nga perëndimi hajt ta përqafojmë - kjo është e mirë. Meqenëse ne nuk jemi në gjendje t’ua adaptojmë rrethanave tona, pas një kohe zhgënjehemi, e shohim se prej saj s’ka asgjë. As ne nuk jemi në gjendje ta gëlltisim dhe as shija e atij modeli nuk përkon me shijen që ne e kërkojmë”. Sipas tij ky është rrezik permanent. Andaj duket paradoksale përvetësimi i vlerave të huaja pa i filtruar dhe pa i kulluar mirë ato në përputhje me kushtet ekzistuese.

Madje është absurde absorbimi i tyre si vlera të reja në mentalitete akoma me botëkuptime të vjetra. Në këtë kontekst si duket ia vlen t’i kthehemi Aristotelit veç sa për të thënë se mesi është më i mirë. Pra për ne do të ishte i preferueshëm ai mes që i sintetizon të dyja aspektet (kolektivizmin dhe individualizmin), duke respektuar si të drejtat bazë të individit ashtu edhe mirëqenien e familjes dhe komunitetit. Komunitarizmi besojmë se përpiqet t’i shmangë dobësitë dhe disavantazhet si të njërës ashtu edhe tjetrës, duke marrë prej tyre si bleta nektarin, vetëm ato vlera që sigurojnë mirëqenie, stabilitet dhe harmoni për të gjithë dhe pa cenuar askënd. Ai pra i jep liri iniciativës private, por njëkohësisht mbështet edhe mirëqenien e komunitetit.

Solidariteti fiktiv dhe nevoja për ta jetësuar solidaritetin konkret

Kundruall një kaskade ndryshimesh që janë bërë në Kosovë me dëbimin e forcave serbe dhe hyrjen e atyre ndërkombëtare, edhe raporti ndaj solidaritetit ka pësuar ndryshime. Më parë ai ishte konkret, kurse tash fiktiv. Pajazit Nushi mendon se ka individë që solidaritetin e tyre e shfaqin në forma joproduktive: janë solidarë në fjalë, por jo solidarë në vepër, kur i mungon familjes së dikujt ushqimi për fëmijë, ai nuk është i gatshëm të ndajë një pjesë të ushqimit të vet, duke llogaritur se ai do t'i nevojitet për një kohë të gjatë, gjersa fëmijët e fqiu të tij nuk kanë ushqim për atë ditë”. Sipas Don Lushit kontrasti është ky: ndërtesat - pallate të ngritura privatisht në Kosovë janë të zbrazëta dhe nuk i përdorë askush, kurse familjet me shumë fëmijë, familjet e varfra dhe të mjera jetojnë në kasolla, të cilat nuk janë as për kafshë, e lëre më për njerëz. Ndoshta vetëm ky shembull është i mjaftueshëm për të ilustruar më së miri ndjenjën e humbur të solidarësisë dhe humanitetit. Me gjasë edhe pronarët e atyre shtëpive shumëkatëshe mund të kenë qenë vetë dëshmitarë të strehimit në shtëpi shumë më të vogla të vëllezërit e tyre në Shqipëri dhe Maqedoni, pas dëbimit nga forcat serbe gjatë eksodit të madh. Dhe për fat të keq si nxënës të dobët nuk kanë përfituar asgjë nga ai leksion.

Pikërisht për shkak të nevojës për një unitet të ri që do t'i anashkalonte stërtheksimet e interesave parciais, Don Lushi mendon se platforma jonë e ardhshme duhet të mbështetet mbi bazat e ndjenjës së përkatësisë së përbashkët. “Sikurse organizmi - thekson ai - që është i përbërë prej shumë gjymtyrëve e që funksionojnë si një tërësi që quhet trup, ashtu është edhe trupi kombëtar. Ne duhet ta dimë se jemi pjesë përbërëse e njëri-tjetrit dhe secili me rolin dhe funksionin që ka duhet të jetë në rend të parë vetvetja, por t’ua mundësojë edhe të tjerëve të jenë vetvetja. Krijimi i një botëkuptimi personal, shijimi i vëllazërisë sonë të përbashkët, dëshirën që të hyjmë në lëkurën, shpirtin dhe zemrën e njëri-tjetrit, të mundohemi të gëzohemi me ata që gëzohen dhe të qajmë me ata që qajnë. Kjo do të ishte platforma, e cila na ndihmon në vetëdijesimin tonë personal, familjar, shoqëror dhe kombëtar. Insistoj në atë që ne nëse dëshirojmë të jemi të lumtur, nëse dëshirojmë ta shijojmë jetën, atëherë medoemos duhet të jemi bamirës. Nuk është në pyetje sa e si, por syri, mendja dhe zemra duhet të jenë gjithmonë të hapura, duart duhet të jenë gjithmonë të gatshme, t’ia shtrijnë dorën njëra - tjetrës për përqaftime vëllazërore. Perspektiva e popullit shqiptar është në krijimin e afërsisë dhe ngrohtësisë sa më të madhe. Përpara se t’i japim dikujt diçka duhet t’i japim vetveten. Kjo është përgjigje në atë që njerëzit thonë “s’kam se do të ndihmoja”. Askush nuk është skamnor në kuptimin se e ka vetveten. Nëse s’ke mundësi materialisht, mund të shkosh e të rrih në shoqëri me njeriun që është i vetmuar a në pikëllim, ashtu që ta ndash hallin dhe dertin me atë që e ka. Vetëm kur njeriu s’ka shpirt dhe zemër është i varfër, sepse varfëria nuk është vetëm materiale, por mbi të gjitha varfëria është shpirtërore. Nuk është i varfër ai që ka tepër pak, por ai që do më shumë. Nënë Tereza thoshte se kanceri i shoqërisë moderne është vetmia, dëbimi, mosdëshira dhe mungesa e dashurisë. Ta zgjojmë dhe të frymëzojmë njëri-tjetrin që të jetojmë me dashuri dhe për dashuri, siç bëri Nënë Tereza e cila thoshte: “Jam e lumtur, sepse 24 orë në ditë jetoj me Zotin dhe për Zotin, jetoj me të afërmit dhe për të afërmit. Ta shijojmë këtë të paktën një ditë në javë dhe atëherë do të shohim se cilësia e jetës sonë do të jetë ndryshe. Mendoj se në këtë kuptim duhet gjithë së bashku t’i ndihmojmë njëri - tjetrit dhe t’ia shtrijmë dorën vëllazërisht njëri - tjetrit, për të ndihmuar, për të kuptuar, për të përkrahur njëri - tjetrin, për t’i dhuruar në rend të parë vetveten, si njohuri dhe si dashuri, atëherë zemra do të na thotë çka na kushton dhe çka kemi mundësi t’i japim njëri - tjetrit. E njeriu sa më tepër që jep, aq më tepër do të ketë. Mendoj se

shoqëria jonë kosovare në këtë moment ka mundësi të mëdha që ta ndihmojë vetveten, pra duhet ta ndihmojmë njëri-tjetrin. Kënaqësia do të ishte pikërisht kjo: se ata që do të ndihmonin do t'i ndihmonin pikësëpari vetvetes, sepse do të ndienin një kënaqësi dhe shijim të posaçëm edhe të jetës edhe të punës edhe të vetë pronave ose pasurisë që kanë. Kjo është urtia për të cilën mësonte Nënë Tereze, e cila thoshte: “të varfrit japin më tepër se sa të pasurit, sepse ata japin ndjenjën e nderimit – të falënderimit. Kur t'i shfrytëzojmë këto ndjenja, të cilat janë diku... ngase vetëm pluhuri a hiri e ka mbuluar gacën tonë, jam thellë i bindur se në shpirtin, në mendjen dhe në zemrën e shqiptarit të gjitha këto ndjenja ekzistojnë. Mirëpo, duhet t'i gjejmë format dhe mënyrat se si të vijmë deri te zemra e njëri - tjetrit me një dëshirë të vetme: të bëjmë mirë dhe përmes kësaj të bëhemi më të mirë. Ky është kuptimi i bamirësisë e jo vetëm t'i ndihmohet dikujt dhe kaq”. Mendimin e tij lidhur me këtë Don Lushi e përfundoi me porosinë se “ne duhet ta çmujmë kujdesin për të varfrit, për të mjerët, dëshirën për të dëgjuar, për t'i kuptuar dhe për t'i ndihmuar të tjerët. Këto janë vlera që nuk guxojmë në asnjë mënyrë t'i humbim” - tërhoqi vërejtjen ai.

Përfundim

Të gjithë ndodhen përpara një të ardhmeje plot me premtime, por edhe me plot rreziqe. Qytetari i varfër shqiptar shpreson se do të pasurohet ose së paku se do ta rrisë nivelin e mirëqenies së tij” (Fuga, 2001:22).“Kudo mbretëron një konfuzion moral çka i bën veprimet njerëzore egoiste, kaotike dhe të paqëndrueshme. Konfliktet shoqërore dhe ndjenjat e xhelozisë, të rivalitetit, të egoizmit, të smirës dhe të pakënaqësisë së përhershme të ushqyera nga individët dhe grupet shoqërore kolektive kundrejt rivalëve të tyre, bëhet dukuri tejet të pranishme dhe e përçajnë duke e shqyer trupin shoqëror tepër delikat...dëshirat janë bërë të papërmbajtshme... rregullat e traditës kanë humbur çdo lloj autoriteti mbi sjelljen njerëzore”(Fuga, 2000:376).

Thirrjet për solidaritet të ndërsjellë për zbutjen e hendekut të pasur e të varfër janë tejet të pamjaftueshme. Zaten ato mund të shndërrohen vetëm në akte simbolike e teatrale ku do të demonstrohej vetëm bamirësia edhe atë vetëm pjesërisht, por jo edhe jo drejtësia.

“Sot një pjesë e bashkëkombësve tonë edhe në Kosovë, po e përjeton procesin e tjetërsimit kulturor, besimor e kombëtar ashtu siç përjeton një njeri i sëmurë përparimin e sëmundjes në organizmin e tij, duke e ndier përparimin e saj, po në të njëjtën kohë duke mos e pasur as guximin që ta pranojë se ai përparim po ndodhë dhe po e shpie drejt ndryshimit jetën e tij. Si edhe të gjitha analogjitë e tjera, edhe këto e kanë një asimetri brenda vetes: përderisa sëmundja nuk është e vullnetshme, nuk është zgjedhje e vetë njeriut të sëmurë, tjetërsimi në rrethanat tona të anarkisë së zgjedhjes, tingëllon si i vullnetshëm, si zgjedhje e lirë e atyre që i janë ekspozuar atij ndryshimi, paçka se në fakt është i nxitur nga naiviteti dhe nga prirje hedoniste që nuk frenohen lehtë”³.

Për fund të themi edhe atë se lënia e kësaj teme në margjina të diskutimit, shtjellimit dhe studimit tash për tash mbetet një ndër enigmat që këtu për këtu nuk mund ta zbërthejmë. Një dukuri që është kaq evidente dhe prezente në çdo pore të jetës sonë me ose pa dashje është anashkaluar si nga mediat elektronike ashtu edhe ato të shkrimit, nga asociacionet

³ Krasniqi, Milazim, ‘Sfidat e tjetërsimit dhe nevoja e edukimit fetar’, gazeta ‘Start’, 22 nëntor 2012 & Revistë kërkimore ‘Media - 4’, Universiteti i Prishtinës, Dega e Gazetarisë, Prishtinë, 2012: Krasniqi, Milazim: ‘DEGRADIMI I VLERAVE KULTURORE SI PRODHUES I DEFORMIMIT NË KOMUNIKIMIN MEDIAL’, f.23

hulumtuese, intelektualët etj. Përkitazi me këtë Anton K.Berishaj mendon “se ne nuk kemi ekspertë të mirëfilltë që do të studionin kalimin nga kolektivizmi në individualizëm. Për të pasur një qasje sadopak për këtë problem duhet të kemi edhe mjete që merren përmes institucioneve të ndryshme. Mendoj se individualisht shumë pak mund të bëhet diçka. Studimi i një dimensionit të këtillë do qasje multidimensionale. Derisa të krijohen rrethanat për një angazhim të këtillë besoj se do të kalojë edhe pak kohë”, - përfundoi ai.

Do të ishte kënaqësi e veçantë që publikimi i këtij punimi të shërbejë të paktën për iniciimin e interesimit për studime edhe më të thella në këtë fushë. Kjo do të ishte në interes dhe në të mirë të të gjithëve.

Referencat:

1. **Fuga**, Artan, ‘*Ikja nga kompleksi i Rozafës*’, Dukagjini, Pejë, 2001
2. **Fuga**, Artan, ‘*Shoqëria periferike*’, Ora, Tiranë, 2000
3. **Fuga**, Artan, ‘*Shtigjet drejt guvës së gjarprit*’, Ora, Tiranë, 1998
4. **Fuga**, Artan, ‘*Majtas JO djathtas*’, Ora, Tiranë, 2003
5. **Delsol**, Chantal, Millon, ‘*Idetë politike në shekullin e XX-të*’, Onufri, Tiranë, 2000
6. **Arent**, Hana “*Ndërmjet të shkuarës dhe të ardhmes*” SHB Onufri, Tiranë, ‘98
7. **Horkheimer**, Max, ‘*Pomračenje uma*’, Veselin Masleša - Svjetlost, Sarajevo, 1989, str.86
8. **Marcuse**, Herbert, ‘*Njeriu njëdimensional*’, Plejad, Tiranë, 2006
9. **Feraj**, Hysamedin, “*Kriza e përkryer e Shqipërisë*”, Eurorilindja, Tiranë, 2003
10. **Brzhezinski**, Zbigniev, ‘*Jashtë kontrollit*’, Elena Gjika, Tiranë, 2001
11. **Steger**, Manfred B., “*Globalizimi, hyrje e shkurtër*”, Co-PLAN, Tiranë, 2005
12. **Goldstein**, Joshua, S., ‘*Marrëdhëniet ndërkombëtare*’, Dituria, Tiranë, 2003
13. **Kullashi**, Muhamedin, ‘*Përplasja e identiteteve*’, Dukagjini, Pejë, 2003
14. **Karagjozi**, Afrim, “*The wisdom of mankind*”, Skanderbeg books, Tiranë 2002
15. **Revistat** “*Sheshi*” dhe ‘*Kosovarja*’; burime nga gazetatat e përditshme si dhe burime nga disa hulumtime
16. **Intervista** me: Prof.dr. Anton K.**Berishaj** - profesor i sociologjisë, akademik Pajazit **Nushi**-profesor i psikologjisë dhe dr. Don Lush **Gjergji** - kryetar i Shoqatës Humanitare Bamirëse “Nëna Terezë”.

